



BASHKIMI I PRODHUESVE SHQIPTARË

PROPOZIMET NGA BASHKIMI I PRODHUESVE SHQIPTARË

1. PËRMIRËSIMI I KLIMËS SË BIZNESIT

a. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe garantimi i sigurisë ligjore, nëpërmjet:

- Respektimit rigoroz të ligjit për konsultimin publik duke bërë ndërhyrje në legjislacionin aktual për penalizimin individual të çdo zyrtari publik që nuk e zbaton këtë ligj;
- Përfshirjes së Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë këshillat/komitetet konsultative për legjislacionin që prek ekonominë;
- Përfshirjes së Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë në tryezat permanente dhe periodike të organizuara nga Ministri për mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Ministrive të tjera të linjës sipas sektorëve;
- Përfshirjen e Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë në procesin e negociimit me BE.

b. Përmirësimi i procesit të inspektimit, nëpërmjet:

- Shtrirjes së inspektimit “online” në të gjithë fushat e inspektimit, si një skemë që mbështet prodhuesit e formalizuar dhe lufton informalitetin;
- Përballimit të tarifave të analizave laboratorike të kërkuara në procesin e inspektimit nga buxheti i shtetit;
- Rishikimit dhe lehtësimit të procedurave për kontrollet dhe vetëkontrollet ndaj sipërmarrjes prodhuese;
- Rregullimit të mbivendosjes së kompetencave të inspektimeve të ndryshme pasi shpesh ka mbivendosje në fushat e kontrollit;
- Heqjes së tarifës së skanimit në dogana pasi bie në kundërshtim me legjislacionin për inspektimin.

c. Përmirësimi i legjislacionit të punës nëpërmjet:

- Rishikimit të gjobave ndaj bizneseve pasi aktualisht vlerat e tyre variojnë nga 20 – 50 rroga duke i vënë bizneset në një presion të papërbalueshëm;
- Rritjes së fleksibilitetit në marrëdhëniet e punës për sa i përket orareve dhe kompensimit të orëve jashtë orarit.

d. Rishikimit dhe unifikimit të procedurave doganore dhe tatimore për sa i përket penaliteteve dhe të drejtës së ankimit.

2. POLITIKA PËR RRITJEN E AFTËSISË KONKURRUESE TË PRODHUESVE VENDAS

Nëpërmjet:

- Heqjes së taksave doganore për artikujt që janë lënde e parë për industrinë prodhuese;
- Heqjes së disa taksave dhe tatimeve të panevojshme të mbetura në sistem pa asnjë vlerë për buxhetin e shtetit, por duke krijuar vështirësi për sipërmarrjen (Taksa e ambalazhit);
- Heqjes së akcizave për lëndët e para djegëse për industrinë prodhuese;
- Reduktimit të taksës mbi artikullin me kod 39235010 (Tapa dhe pipeta për prodhimin e shisheve plastike). Kjo tarifë arrin në 50 % të çmimit të blerjes së këtij artikulli ndërkohë kur në vendet e rajonit është 0 ÷ 6 % (Greqi 0 %, Kosovë 0 %, Mali i zi 3 %, Maqedonia 6 %, Bullgari 0 %). Kjo taksë, që i vë në vështirësi të gjitha industritë vendase, propozojmë të ulet nga 100 lekë / kg në 10 lekë / kg dhe të shtrihet, pa përjashtim, në të gjithë produktet dhe ambalazhet plastike.
- Rishikimit të legjislacionit për rimbursimit të TVSH dhe Akcizës duke hequr kushtëzimin e rimbursimit me kontrollin e detyrueshëm ndaj subjekteve dhe duke përcaktuar sanksione ndaj administratës shtetërore për vonesa në rimbursim;
- Rishikimit në ulje të nivelit të taksave lokale duke patur në konsideratë që shpesh herë taksat e përkohshme kthehen në të përhershme pa një afat të përcaktuar duke tejkaluar të drejtat ligjore;
- Rishikimit në ulje të nivelit të taksës së pasurisë mbi ndërtesat e industrive prodhuese deri në masën 50 lek/m²;
- Heqjes së plotë të TVSH në import për makineritë/pajisjet për prodhuesit vendas;
- Mbështetjes shtetërore deri në masën 50 % për pagesat e sigurimeve shoqërore për vendet e reja të punës (për një afat 6 mujor) në ndihmë të industrive prodhuese;
- Uljes së çmimit për energjinë elektrike për sipërmarrjen prodhuese duke ju referuar vendeve të rajonit (megjithatë pretendohet të punojmë në një treg të liberalizuar i energjisë elektrike të rishikohen tarifat e transmetimit me objektivin që të mos kalojnë tarifat e rajonit);
- Rritjes së investimeve për përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike për sipërmarrjen prodhuese;
- Lehtësimit të procedurave doganore dhe kufitare duke rritur fleksibilitetin në orare dhe duke shpejtuar kohët e kontrollit;
- Rishikimit të tarifave për shërbimet portuale;

- Rritjes së mundësisë për sipërmarrjen prodhuese për aksesin në financime në një treg financiar të diversifikuar;
- Rinovimit të Parkut të Mekanikës Bujqësore dhe shtimi i linjave të përpunimit të lëndëve të para në vend, me qëllim rritjen e performancës dhe nivelit të prodhimit kombëtar në zonat rurale, që të jetë sa më konform normave dhe standarteve komerciale rajonale e evropiane.
- Reduktimit të kostove energjetike, nëpërmjet zëvendësimit të karburantit të importuar me karburant të prodhuar dhe përpunuar në vend, program i hartuar që mund të zbatohet pa asnjë kosto shtesë për buxhetin e shtetit.
- Uljes së moderuar e nivelit të TVSH dhe përshkallëzimin në zbritje për disa sektorë specifik dhe barazimin e TVSH-së së ushqimeve me ato të nivelit rajonal dhe evropian.

3. ULJA E INFORMALITETIT

- Futjes së TVSH-së në tregun e shitjes në pakicë;
- Riorganizimi i strukturave tatimore dhe doganore për mundësuar luftën ndaj informalitetit;
- Shtrirja e inspektimit edhe të subjektet informale;
- Rishikimi i legjislacionit për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor, duke formalizuar dhe përsosur më tej strukturën e tyre organizative, në nivel lokal dhe kombëtar.
- Hartimi dhe implementimi i regjistrit elektronik të fermës, kartës elektronike të fermerit, si dhe krijimi i Qendrës Kombëtare të Agrobiznesit.